

Seancë Plevale  
Zall



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KUVENDI**  
*Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

**Lënda:** Kërkesë për interpelancë urgjente me ministren Belinda Balluku.

**Drejtar:** Znj. Lindita NIKOLLA  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Koncessionari privat që menaxhon "Rrugën e Kombit" ka vendosur në hyrjen dhe daljen e qytetit të Milotit disa bariera betoni, të cilat pengojnë aksesin e lirë të qytetarëve në këtë rrugë. Kjo ka sjellë pengimin e qytetarëve për të lëvizur lirisht në këmbë apo me automjete, si dhe ka dëmtuar gjendjen e bizneseve të zonës, të cilët janë detyruar të mbyllin aktivitetet e tyre. Sic është raportuar edhe nga mediat, banorët e zonës kanë ngritur në mënyrë të përsëritur shqetësimin lidhur me bllokimin e aksesit në "Rrugën e Kombit" të qytetarëve të Milotit. Megjithatë, këto shqetësime kanë rënë në vesh të shurdhët dhe deri më tani nuk është marrë asnjë masë për zgjidhjen e kësaj problematike.

Nga ana tjetër, me përfundimin e punimeve për ndërtimin e segmentit Thumanë – Kashar, është vërejtur se në zonën e Thumanës është mbyllur dalja në rrugën e vjetër që mundëson lidhjen e zonës së Milotit, por edhe automjetet e tjera që vijnë nga veriu me zonën e Fushë Krujës dhe Kamzës. Pra, qytetarët që vijnë nga Veriu mund të lidhen me zonën e Fushë Krujës dhe Kamzës vetëm nëpërmjet daljes në Rinas, pasi ka paguar tarifën 2.1 Euro të rrugës. Përvecse kjo rrit distancën për qytetarët që udhëtojnë nga veriu me destinacion Fushë Krujën apo Kamzën, kjo rrit edhe koston, pasi në këtë mënyrë pamundësohet aksesimi i rrugës së vjetër, e cila është pa pagesë.

Të dy vendimmarrjet e mësipërme duket të janë bërë vetëm në interesin e koncessionarëve privatë, pa marrë parasysh vështirësitë, kostot dhe dëmet që shkaktojnë për qytetarët dhe bizneset, përdorues të këtyre segmenteve rrugore. Në këto kushte, me qëllim dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve lidhur me sa më lart, në cilësinë e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 97, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, kërkojmë zhvillimin e një interpelancë urgjente me Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku. Interpelanca do të paraqitet nga deputetja Elda Hoti.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETËT

1- Garment Barolli  
2- Elda Hoti

3. Tito Shala s. Andria Ulqiri  
4. Bajram Gjonaj

6. Soriee Koto ~~Koto~~

7. Ido Short ~~Ido~~